

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRIN

02 Nr. / Br 754/21

Nr. i fq. / Br. sht 1

Data: / Datum 07.07.2021

VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe duke iu referuar nenit 4 pika 4 të Memorandimit të Mirëkuptimit mbi zbatimin e projektit të dorëzuar tek Zyra e BE-së në Kosovë dt. 19.06.2021, të nënshkruar në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Skenderajt, Qendrës Kosovare për Vetë Përkrahje dhe Shoqatës “Handikos” dega në Vushtrri, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M  
PËR CAKTIM TË ORGANIT MBIKËQYRËS

1. Z. Naim Ferizi, zyrtar në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, caktohet organ mbikëqyrës për mbikëqyrje të implementimit të Memorandimit të Mirëkuptimit datë 19.06.2021 mbi zbatimin e projektit të dorëzuar tek Zyra e BE-së në Kosovë, “Rritja e Punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuar përmes zbatimit të Planit Lokal të Veprimit për punësimin e PAK në Komunitet e Skenderajt dhe Vushtrrisë të nënshkruar në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Skenderajt, Qendrës Kosovare për Vetë përkrahje dhe Shoqatës “Handikos” dega në Vushtrri.
2. Organi mbikëqyrës, duhet të ndërmerr të gjitha masat dhe aktivitetet e mbikëqyrjes së Memorandimit të Mirëkuptimit të cekur në pikën paraprake në pajtim me obligimet e përcaktuara të palëve nënshkruese, duke bashkëpunuar ngushtë me përfaqësuesin e Qendrës Kosovare për Vetë Përkrahje si implementues i projektit..
3. Organi mbikëqyrës nga pika një (1) e këtij vendimi duhet të mbaj të informuar në çdo Kryetarin e Komunës përmes raporteve me shkrim për ecurinë e implementimit të këtij projekti. Organi në fjalë në bashkëpunim me përfaqësuesin e Qendrës Kosovare për Vetë Përkrahje do të dorëzojnë raport të përbashkët me shkrim për finalizim të projektit në Drejtorinë për buxhet dhe financa me qëllim të kryerjes së pagesave nga buxheti i komunës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Z. Naim Ferizi
- Arkivit të Sekretarisë



REPublika e Kosovës - Republika Kosovo  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br 803/21

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 19.07.2021

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 8 paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në propozimin e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim dt. 19.07.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M  
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA FATKEQËSITË  
NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA

1. Themelohet Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera për Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
  - 1.1 **Bajram Beqiri**, ekonomist- sekretar dhe kryesues i komisionit,
  - 1.2 **Tefik Maloku**, ing. i bujqësisë, anëtar
  - 1.3 **Ramiz Maliqi**, ing. anëtar,
  - 1.4 **Islam Latifi**, ing. Anëtar,
  - 1.5 **Sami Ibishi**, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi, detyrat e tija do të i kryej në pajtim me nenin 12 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera.
3. Mandati i komisionit është 4 vjet nga dita e miratimit të këtij vendimi.
4. Lartësia e kompensimit për punë të këtij komisioni dhe komisioneve profesionale mund të bëhet me vendim të veçantë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Anëtarët e Komisionit, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe drejtoritë tjera sipas nevojës.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet e më parme për formim të këtij komisioni.
7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi ju dërgohet:

- Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim,
- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të Sekretarisë.



Xhafer Tahiri  
Kryetar i Komunës





REPublika e Kosovës - Republika Kosovo  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 802/21

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 19.07.2021

VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), si dhe nenit 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në Kërkesën e Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dt. 19.07.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M P E R F O R M I M T Ë K O M I S I O N I T

1. Formohet komisioni për vlerësim të dëmit në terren (në fsh. Novolan), në këtë përbërje:
  - 1.1 **Ahmet Shuku**, kryesues i komisionit,
  - 1.2 **Isa Latifi**, anëtar,
  - 1.3 **Egzon Haradinaj** anëtar.
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të bëjë vlerësimin e dëmit të shkaktuar gjatë ekzekutimit të punëve në terren me rastin e zbatimit të projektit “Asfaltimi i rrugës lokale në fsh. Novolan”.
3. Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e vlerësimit të këtij dëmi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



**Xhafer Tahiri**

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit të Sekretarisë